

Dr. Musli Vërbani

Trashëgimia - Feraidi
(për fillestarë)

Kaçanik

DEFINICIONI I TRASHËGIMISË

Në aspekt gjuhësor (etimologji) fjala “mirath” vjen nga infinitivi “vrithe”, “jerithu”, “irthen”, që ka kuptimin e kalimit të një sendi prej një personi në personin tjetër.

Në aspekt terminologjik fjala “mirath” ka kuptimin e kalimit (bartjes) të pronësisë nga i vdekuri te pasardhësit e gjallë, pa marrë parasysh a është sendi i lënë pasuri e patundshme apo e patundshme apo e drejtë juridike e sheriatit.

Fjala **trashëgimi** ka edhe kuptim abstrakt, si fjala vjen, trashëgimia në pasuri, dituri ose nder. Muhamedi s.a.v.s. ka thënë: **“Dijetarët janë trashëgimtarë të pejgamberëve. Pejgamberët nuk kanë lënë (trashëgimi) as dërrhem e as dinarë, por kanë lënë pas vete dituri, e kush e merr atë dituri, e ka marrë pjesën më të mirë.”**

Tematika e mirathit (trashëgimisë) – Kjo shkencë merret me mënyrën e ndarjes së pasurisë që e lë i vdekuri tek meritoret (trashëgimtarët).

Vlera: Kjo shkencë ka vlerë të rëndësishme dhe të pazëvendësueshme, dhe zbatimi i saj bën që pasuria të shpërndahej në mënyrë të drejtë, dhe mungesa e saj do të shkaktonte trazira dhe çrregullime të mëdha.

Baza: Kjo shkencë burimin e ka nga Kur’ani, suneti dhe ixhmai.

Ruknet e trashëgimisë

Ruknet e trashëgimisë janë:

1. **I trashëguari.** Me këtë për qëllim *personin e vdekur*, sepse nëse nuk ka vdekur personi atëherë nuk ka trashëgimi.
2. **E trashëguara.** Me këtë kemi për qëllim *pasurinë e trashëguar*.
3. **Trashëgimtari.** Me këtë kemi për qëllim personin i cili ka të drejtë të trashëgojë.

Sharti i trashëgimisë

1. **Vdekja** e trashëgimlënësit, qoftë fizikisht (hakikatun) qoftë juridikisht (hukmen).

2. **Gjallëria** e trashëgimtarit. Ai i cili trashëgon duhet të jetë i gjallë sepse i vdekuri nuk ka të drejtë trashëgimie.

3. **Ekzistimi i bazës juridike** për të trashëguar.

Shkaqet e trashëgimisë

Shkaqet e trashëgimisë janë:

1. **Afërsia nga gjaku.** Ku bëjnë pjesë:

- djemtë dhe vajzat;
- nipat dhe mbesat;
- babai dhe nëna;
- vëllezërit dhe motrat;
- gjyshi dhe gjyshja;
- axhallarët dhe të tjerët.

2. **Lidhja e kurorëzimit** të plotfuqishëm juridikisht. Burri e trashëgon gruan dhe grua e trashëgon burrin.

3. **Pronësimi.** Nëse një pronar/pronare (pronar i robit) e liron robin/robëreshën e tij dhe i liruari/liruara vdes dhe nuk ka trashëgimtarë, atëherë masa trashëgimtare bartet te pronari/pronarja e tij.

Pengesat e trashëgimisë

I penguar apo i ndaluar që të trashëgoj është personi, i cili, në esencë ka pasur të drejtë trashëgimie, por ndodh diçka që atë e ndalon të trashëgojë.

Pengesat e trashëgimisë janë:

1. Robëria.

Robëria është lloj i pronësimit apo posedimit. Robi nuk ka të drejtë trashëgimie, çfarëdo qoftë ajo.

2. Vrasja e trashëgimlënësit.

Dijetarët janë pajtuar se vrasësi nuk trashëgon prej atij të cilin e ka vrarë. Muhamedi s.a.v.s. ka thënë: **“Vrasësi nuk ka të drejtë trashëgimie.”**

3. Largimi nga feja.

Kush largohet nga feja dhe pranon fe tjetër, ai nuk trashëgon prej besimtarit. Mendimi i Ebu Hanifes është që, pasurinë që renegati (i daluri nga feja) e ka fituar para se të largohet nga feja e trashëgojnë të afërmit e tij, ndërsa pasurinë të cilën e ka fituar pasi që është larguar nga feja deponohet në arkën qendrore (bejtul mal) të muslimanëve.

4. Dallimi fetar.

Muslimani nuk trashëgon prej jomuslimanit dhe anasjelltas.

Vlen të theksohet se sa i përket **ndryshimit të vendor**, apo jetesës së muslimanëve nëpër vende të ndryshme, kjo nuk është pengesë për trashëgimi, qoftë vendi islam, qoftë joislam. Pra, muslimani e trashëgon muslimanin pa marrë parasysh se në çfarë vendi jeton.

Si duhet vepruar me pasurinë e të vdekurit?

Pasi të vdes njeriu, me pasurinë e tij vepronhet kështu:

1. Nga pasuria e të vdekurit kryhen shpenzimet e varrimit të tij;
2. Nga pasuria e të vdekurit paguhet borxhi i tij ndaj njerëzve, si dhe borxhet e adhurimeve (ndaj Allahut) siç janë: zekati, haxhi, etj.
3. I zbatohet testamenti deri në një të tretën e pasurisë e më pak. Nëse ka lënë testament më shumë se një e treta ($1/3$) nuk i zbatohet në tërësi, por vetëm deri në masën e një të tretës.
4. Pas plotësimit të katër procedurave paraprake, fillon procedura e trashëgimisë.

Llojet e trashëgimtarëve

Për nga lloji, trashëgimtarët ndahen në:

1. Trashëgimtarë farz;
2. Trashëgimtarë asaba (trashëgimtarë farz dhe teasibë)
3. Trashëgimtarë rimarrës (teasibë);
4. Trashëgimtarë farefisnorë.

Trashëgimtarët për nga gjinia

Trashëgimtarët e gjinisë mashkullore ndahen kështu:

1. Loza e poshtme;
 - djali;
 - djali i djalit...
2. Loza e epërme;
 - babai;
 - gjyshërit...
3. Ana e djathtë (e fortë);
 - vëllai i vërtetë;
 - vëllai prej babait;
 - vëllai prej nëne;
 - djali i vëllait;
 - djali i vëllait prej nëne.
4. Ana e majtë (e dobët).
 - axha i vërtetë;
 - axha prej babait;
 - djali i axhës;
 - djali i axhës prej babait;
 - *burri*;
 - *i liruari prej robërie*.

Për sqarim më të mirë, shihni figurën e mëposhtme:



Trashëgimtarët e gjinisë femërore ndahen kështu:

1. Loza e poshtme;
 - vajza;
 - vajza e djalit...
2. Loza e epërme;
 - nëna;
 - gjyshet...
3. Ana e djathtë (e fortë);
 - motra;
 - motra prej babait;
 - motra prej nënës.
4. Ana e majtë (e dobët).
 - *gruaja*;
 - *e liruar*.

AS'HABUL FURUD – PERSONAT E NOMINUAR PËR TË MARRË PJESË TË PËRCAKTUARA (FARZ)

Për nga masa, pjesë të përcaktuara në Kur'an janë këto:

- 1/2;
- 1/4;
- 1/8;
- 2/3;
- 1/3;
- 1/6.


Numri i personave të nominuar për të marrë pjesë të përcaktuar (farz) është dymbëdhjetë, e ata janë:

- Katër të gjinisë mashkullore; dhe
 - babai;
 - gjyshi nga babai e më lart;
 - vëllai nga nëna; dhe
 - burri.
- Tetë të gjinisë femërore.
 - nëna;
 - vajza;
 - vajza e djalit;
 - gruaja;
 - motra prej nëne e babai;
 - motra prej nëne;
 - gjyshja e vërtetë e më lart.

Më poshtë po i paraqesim trashëgimtarët farzmarrës sipas masës:


1/2 trashëgojnë:

- Vajza;
- Burri;
- Gruaja.



1/4 trashëgojnë:

- Burri;
- Gruaja.



1/3 trashëgojnë:

- Nëna;
- Vëllezërit;
- Motrat prej nëne.

1/3



2/3 trashëgojnë:

- Vajzat;
- Motrat.

2/3



1/6 trashëgojnë:

- Dy prindërit;
- Nëna;
- Vëllai ose motra prej nëne.


1/6



1/8 trashëgon:

- Gruaja.

1/8



PARIMI I MBULIMIT TRASHËGIMOR NË TRASHËGIMINË ISLAME


Me fjalën **mbulim** nënkuptohet pengimi i një personi të caktuar nga e tërë trashëgimia ose nga një pjesë e trashëgimisë së tij, për shkak të ekzistencës së një personi (trashëgimtari) tjetër.

Mbulimi është dylojësh:

- Mbulim i tërësishëm;
- Mbulim i pjesshëm.

Mbulim i tërësishëm

Mbulimi i tërësishëm, është ndalimi i tërë trashëgimisë për një person për shkak të ekzistencës së një tjetri, si p.sh. ndalimi i trashëgimisë së vëllait kur ekziston djali.



Gjashtë trashëgimtarë nuk mund të mbulohen tërësisht, e ata janë:

1,2. **Prindërit**: babai dhe nëna;

3,4. **Fëmijët**: djali dhe vajza;

5,6. **Bashkëshortët**: burri dhe gruaja.

Mbulimi, në trashëgiminë islame mbështetet në dy baza, e ato janë:


Cilido person që lidhet me të vdekurin me anë të një personi, nuk trashëgon nëse ekziston ky person, si p.sh. djali i djalit. Pra, djali i djalit nuk trashëgon nëse ekziston djali. Pra rregull është që përparësi t'i jepet më të afërmit ndaj më të largët.

Nëse janë të të njëjtit nivel, atëherë bazohet në forcën e afërsisë, si p.sh. vëllai prej nëne e babai e mbulon vëllanë vetëm prej babai.


Mbulimi i pjesshëm

Mbulimi i pjesshëm është pakësimi i trashëgimisë së ndonjërit prej trashëgimtarëve për shkak të ekzistencës së një tjetri. Kjo bie mbi pesë person:

1. Burrit, i pakësohet trashëgimia nga gjysma në një të katërtën, kur e vdekura lë pas vetes fëmijë:




1. burri, kur e vdekura nuk ka fëmijë




2. burri, kur gruaja ka fëmijë

2. Gruas, i pakësohet trashëgimia nga një e katërta në një të tretën, kur ekziston fëmija.




1. gruaja, kur burri nuk ka fëmijë




2. gruaja, kur burri ka fëmijë

3. Nënës i pakësohet trashëgimia nga një e treta në një të gjashtën kur ekziston pasardhësi trashëgues.

Nëna trashëgon një të gjashtën nëse me të ekziston një djalë apo djalë djali, dy vëllezër apo motra, qofshin këta nga ana e babait dhe nënës apo vetëm nga ana e babait apo vetëm nga ana e nënës. **“Për çdonjërin prind të të vdekurit – u përket një e gjashta nga pasuria e trashëguar, nëse i vdekuri ka lënë fëmijë.”**



1. nëna, kur nuk ekzistojnë fëmijët




2. nëna, kur ekzistojnë fëmijët

4. Vajza e djalit, trashëgon $\frac{1}{2}$ farz, por nëse i vdekuri lë pas vetes një vajzë atëherë prej $\frac{1}{2}$ kalon në $\frac{1}{6}$, që do të thotë se vajza e djalit me vajzën së bashku trashëgojnë $\frac{2}{3}$.




1. vajza e djalit, kur nuk ekziston vajza




2. vajza e djalit, kur ekziston vajza. Që të dyja së bashku trashëgojnë $\frac{2}{3}$.

5. Motra nga babai, trashëgon $\frac{1}{2}$, por nëse i vdekuri lë pas vete një motër të vërtetë, atëherë nga $\frac{1}{2}$ farz kalon në $\frac{1}{6}$ farz.



a.motra nga babai, kur i vdekuri nuk lë pas vete një motër të vërtetë.



b. motra nga babai, kur i vdekuri lë pas vete një motër të vërtetë.

Privimi nga trashëgimia

Me **privim nga trashëgimia** nënkuptojmë ndalimin e një personi të caktuar nga trashëgimia e tij, për shkak të vërtetimit të ndonjë prej pengesave të trashëgimisë, si p.sh., vrasja, etj.

Dallimi në mes të privuarit dhe të mbuluarit

Dallimi në mes të mbulimit dhe privimit ekziston në dy pika:

E para:

I privuari nuk e gëzon fare të drejtën e trashëgimisë, si p.sh. vrasësi i trashëgimlënësit, ndryshe nga i mbuluari i cili pengohet për shkak të ekzistencës së një personi tjetër që ka përparësi ndaj tij.

E dyta:

I privuari nuk ndikon tek të tjerët dhe nuk mbulon kënd, por konsiderohet inekzistent. Nëse vdes një person dhe lë një fëmijë jobesimtar dhe një vëlla musliman, trashëgimia e tëra i takon vëllait, kurse të birit nuk i takon asgjë. **Ndërsa i mbuluari** mund të ndikoj tek të tjerët si *pengues*, qoftë me mbulim të tërësishëm qoftë me mbulim të pjesërishëm, si f.v., dy apo më shumë vëllezër, me ekzistencën e babait dhe nënës nuk trashëgojnë për shkak të ekzistencës së babait, por ata e mbulojnë nënën pjesërisht dhe ia pakësojnë pjesën nga një e treta në një të gjashtë.

TRASHËGIMIA E BABËS

Sipas të drejtës islame, djali trashëgon nga baba, por edhe baba trashëgon nga djali. Që të dy janë meshkuj, që do të thotë se janë të njëjtës gjini, e gjinia është lloj, dhe për nga afërsia e gjakut janë të të njëjtës kategori, sepse në mes të vdekurit dhe trashëgimtarëve nuk ka asnjë brez ndërmjet, por janë të drejtpërdrejtë.


Babai trashëgon në tri mënyra:

Opsioni i parë


Babai trashëgon pjesën e përcaktuar, **një të gjashtë**, nëse me të ekziston edhe një pasardhës trashëgimtar mashkull, qoftë i vetëm apo me tjetër person.

Kur vdes një njeri dhe pas vete lë **babanë** dhe vetëm **një djalë**, atëherë baba merr $1/6$ ndërsa djali $5/6$, që do të thotë se djali i të vdekurit merr 5 herë më shumë se baba i të vdekurit.


“Për prindërit, secilit prej tyre u takon një e gjashta nga ajo që ka lënë (i vdekuri) nëse ka fëmijë.”



Mund të ndodh që baba të merr baras ose më shumë se sa djali sepse njeriu nuk mund të ketë më shumë se një babë, ndërsa mund të ketë më shumë se një fëmijë. Nëse vdes një njeri dhe i lë **5 djem** dhe **babën**, në këtë rast baba merr sa secili djalë veç e veç.



Ashtu siç vajza trashëgon nga baba, ashtu trashëgon edhe baba nga vajza. Njëri është i gjinisë mashkullore ndërsa tjetri i gjinisë femërore. Nëse i vdekur lë **babën** dhe **një vajzë**, atëherë vajza merr sa baba.




Në këtë rast, baba merr $1/6$ farz si dhe pjesën që mbetet nga personat që marrin farz. Kurse vajza në këtë rast ka marrë vetëm gjysmën farz ($3/6$). Pra, pasi që është trashëguar pjesa farz ($4/6$) ka mbetur pjesa tjetër ($2/6$) të cilën e trashëgon baba, e jo vajza.

Mënyra e dytë

Baba trashëgon mbetjen, nëse me të vdekurin nuk ka pasur pasardhës trashëgues, qoftë mashkull apo femër. Në këtë rast ai merr tërë trashëgiminë nëse është i vetëm apo pjesën që mbetet nga pjesa e trashëgimtarëve që marrin detyrimisht nëse me babanë ekziston njëri prej tyre.

Nëse i vdekuri nuk ka pasur pasardhës trashëgues, qoftë mashkull apo femër dhe pas vete lë **babën** dhe **nënë**n, atëherë baba i merr $\frac{2}{3}$ ndërsa nëna $\frac{1}{3}$.

“...e nëse (i vdekuri) nuk ka fëmijë e atë e trashëgojnë (vetëm) prindërit, atëherë nënës së tij i takon një e treta”.



Mënyra e tretë (pjesën përcaktuese dhe teasibë/mbetjen)

Ai trashëgon pjesën farz dhe teasibë. Kjo ndodh nëse me të ekziston një pasardhës trashëgues femër. Këtu ai merr një të gjashtën farz si dhe pjesën që mbetet nga personat që marrin farz.

TRASHËGIMIA E NËNËS


Nëna trashëgon në tri mënyra:

Mënyra e parë

Nëna trashëgon $\frac{1}{3}$ e tërë pasurisë, nëse i vdekuri nuk lë pas vete:

- Një djalë apo djalë djali;
- Dy vëllezër apo motra, qofshin këta nga ana e babait dhe nënës apo vetëm nga ana e babait apo vetëm nga ana e nënës.

“... e trashëgojnë prindërit dhe nënës i bie një e treta.” (En Nisa : 11)




Mënyra e dytë

Nëna trashëgon $\frac{1}{6}$ nëse i vdekuri lë pas vete:

- një djalë apo djalë djali;
- dy vëllezër apo motra, qofshin këta nga ana e babait dhe nënës apo vetëm nga ana e babait vetëm apo vetëm nga ana e nënës.

“Për çdonjërin prind të të vdekurit – u përket një e gjashta nga pasuria e trashëguar, nëse i vdekuri ka lënë fëmijë...”

“...në qoftë se ai (i vdekuri) ka vëllezër, nënës së tij i takon vetëm një e gjashta...” (En-Nisa, 11)



Në këtë rast nënës i takon $\frac{1}{6}$, kurse vëllait i takojnë $\frac{5}{6}$, sepse Muhamedi a.s. ka thënë:

“Jepuani pjesën farz farzmarrësve (atyre që u takon trashëgimia farz), e çka të mbetet jepjani burrit mashkull.”

Pra, nëna ka marrë $\frac{1}{6}$, pra 1 pjesë farz, kurse vëllai $\frac{5}{6}$, 5 pjesë teasibë.

Mënyra e tretë


Nëna trashëgon $\frac{1}{3}$ e mbetur pas ndarjes së pjesës farz kur nuk ekzistojnë:

- djali apo djalë djali;
- dy vëllezër apo motra, qofshin këta nga ana e babait dhe nënës apo vetëm nga ana e babait apo vetëm nga ana e nënës.
- Nëse përmbushen dy kushtet e mësipërme, si dhe trashëgon bashkëshorti i të vdekurit. E kjo ndodh në dy raste, të quajtura **El Guraija**:
 - E para: kur **gruaja** lë pas vetes burrin dhe dy prindërit;
 - E dyta: kur **burri** lë pas vete gruan dhe dy prindërit.

E para: Kur gruaja lë pas vetes burrin dhe dy prindërit.

Nëse e vdekura lë pas vetes nënën, babën dhe burrin:


- Nëna $\frac{1}{4}$, 1 pjesë farz pas farzit;
- Baba $\frac{1}{4}$, 1 pjesë teasibë;
- Burri $\frac{1}{2}$, 2 pjesë farz.



E dyta: Kur burri lë gruan dhe dy prindërit

Nëse i vdekuri lë pas vetes gruan, babën dhe nënën.

- Nëna $1/4$, 1 pjesë farz pas farzit;
- Baba $1/2$, 2 pjesë teasibë;
- Gruaja $1/4$, 1 pjesë farz.



TRASHËGIMIA E BURRIT

Ashtu sikurse e trashëgon gruaja burrin ashtu edhe burri trashëgon gruan.


Burri posedon dy opsione për të trashëguar, e ato janë:

Opsioni i parë

Burri trashëgon **gjysmën** ($1/2$) e pasurisë së gruas:

- nëse i vdekuri nuk lë pasardhës trashëgues, që është djali e poshtë, vajza, vajza e djalit, qoftë prej tij apo prej tjetri.

“Juve ju takon gjysma e asaj (pasurie) që e lënë gratë e tuaja nëse ato nuk kanë fëmijë.” (En-Nisa, 12)




Opsioni i dytë

Burri trashëgon një të katërtën:

- nëse e vdekura nuk ka pas pasardhës trashëgues.

“Nëse ato kanë fëmijë, juve ju takon një e katërta nga ajo që ato lënë”. (En-Nisa, 12).



Një e katërta burrit, tri të katërtat djalit.

TRASHËGIMIA E GRUAS


Gruaja për të trashëguar posedon dy opsione e ato janë:

Opsioni i parë

Gruaja trashëgon një të katërtën:

- kur nuk ekziston pasardhësi trashëgues, qofshin prej saj apo prej ndonjë tjetre.

“Atyre (grave) ju takon një e katërta nga ajo që ju lini nëse nuk keni fëmijë.




Gruaja një të katërtën, baba tri të katërtat.

Opsioni i dytë

Gruaja trashëgon një të tetën:

- kur ekziston pasardhësi trashëgues.

“Nëse keni fëmijë, atyre ju takon një e teta nga ajo që lini.” (En-Nisa, 12).



TRASHËGIMIA E VAJZËS


Vajza posedon tri opsione për të trashëguar e ato janë:

Opsioni i parë

Vajza trashëgon gjysmën ($1/2$):

- Nëse i vdekuri nuk lë djalë; dhe
- nëse nuk i bashkëngjitet ndonjë vajzë tjetër (motra e saj).

Zoti i Lartmadhëruar thotë: “Nëse është një femër – i takon gjysma e pasurisë.” (En-Nisa, 11).




Vajza $1/2$, burri $1/2$.

Opsioni i dytë

Vajza trashëgon dy të tretat ($2/3$):

- nëse janë dy ose më shumë; dhe
- me to nuk ekziston ndonjë djalë apo më shumë.

Zoti i Lartmadhëruar thotë: “Nëse trashëgimtarë janë dy e më tepër femra, atyre u takojnë dy të tretat nga trashëgimia.”



Babai $1/3$, dhe dy vajzat nga $1/3$.


Opsioni i tretë

Vajza trashëgon pjesën e papërcaktuar farz (TEASIBË).

- nëse me të ekziston një djalë apo më shumë.

Në këtë rast, mashkulli merr sa dy pjesë të femrës. E njëjta gjë aplikohet nëse numri i vajzave apo i djemve është më shumë se një.

“Allahu ju urdhëron për trashëgiminë tuaj, mashkullit i takon aq sa pjesa e dy femrave. (En-Nisa : 11)



Djali 2/4 apo gjysmën, kurse vajzat nga 1/4.

TRASHËGIMIA E VËLLAIT DHE MOTRËS PREJ NËNE SIPAS SË DREJTËS ISLAME

Opsioni i parë

Nuk trashëgojnë asgjë:


- Nëse ekziston pasardhësi trashëgues, si p.sh., djali apo djali i djalit; dhe
- Nëse ekziston paraardhësi trashëgues mashkull, si p.sh. babai apo gjyshi;
- Nëse ekziston nëna apo gjyshja dhe me to nuk është baba apo gjyshi, dhe kësioj nëna apo gjyshja nuk mbulohet.

Vëllai prej nëne mbulohet prej pasardhësve, paraardhësve dhe vëllait të vërtetë.

Opsioni i dytë

Trashëgojnë një të gjashtën për një person të vetëm, qoftë mashkull apo femër.


“Nëse i vdekuri, qoftë burrë ose grua, është pa prindër dhe fëmijë, por ka vëlla ose motër (prej nënës) atëherë çdonjërit prej tyre u takon një e gjashta.” (En Nisa : 12)



Vëllai prej nëne një të gjashtën, vëllai i vërtetë pesë të gjashtat.

Opsioni i tretë

Trashëgojnë një të tretën për dy dhe më shumë, ku meshkujt dhe femrat trashëgojnë barabartë. Zoti i Lartmadhëruar thotë: **“E në qoftë se janë më shumë (se një vëlla ose se një motër) ata janë pjesëmarrës të barabartë në të tretën (e tërë pasurisë).”** (En Nisa : 12)



Burri një të dytën, nëna një të gjashtë, vëllai dhe motra secili nga një të gjashtën që do të thotë së bashku një të tretën.

TRASHËGIMIA E MOTRËS SË VËRTETË

Motrat prej nëne e babai posedojnë pesë opsione:

Opsioni i parë

Nuk trashëgojnë asgjë, atëherë kur:


Ekzistojnë pasardhësit trashëgues meshkuj, si p.sh. djali dhe djali i tij, si dhe paraardhësit trashëgues meshkuj sikurse babai, e kjo me konsensus të dijetarëve (dhe gjyshi tek Ebu Hanife, ndryshe nga Ebu Jusufi dhe Muhamedi).

Opsioni i dytë

Motra trashëgon gjysmën kur:

- Është vetëm një motër;
- Me të nuk ekziston asnjë djalë apo djalë djali;
- Me të nuk ekziston as babai, as gjyshi;
- Dhe me të nuk ekziston as vëlla prej nëne e babai.

Zoti i Lartmadhëruar thotë: **“Ata kërkojnë nga ti (Muhamed) gjykim (për dikë që vdes dhe nuk lë trashëgimtarë). Thuaju: Allahu ju udhëzon juve për një njeri të tillë. Nëse një burrë vdes pa pasur fëmijë (dhe prindër), ndërkohë që ka një motër, atëherë asaj i takon gjysma e trashëgimisë.” (En Nisa : 176)**




Burri trashëgon një të dytën, motra e vërtetë një të dytën.

Opsioni i tretë

Trashëgojnë dy të tretat kur:

- Janë dy motra e më shumë;
- Nëse mungojnë meshkuj, pra vëllezërit e tyre;
- Nëse nuk ka lozë të poshtme;
- Nëse nuk ka lozë të epërme;


Zoti i Lartmadhëruar thotë: **“Në qoftë se një burrë pa fëmijë (dhe prindër) ka dy motra, atëherë ato do të trashëgojnë dy të tretat e pasurisë.” (En Nisa : 176)**



Nëna një të tretën, motrat dy të tretat.

Opsioni i katërt


Nëse me to është një vëlla prej nëne e babai e nuk ekzistojnë pasardhësit trashëgues meshkuj, si p.sh. djali dhe djali i tij, e paraardhësit meshkuj si baba, atëherë vëllai i vërtetë merr sa dy motra të vërteta.



Dy motrat nga një të katërtën, vëllai një të dytën.

Opsioni i pestë

Motrat kthehen në bashkëpjesëmarrje (asaba) me vajzat ose vajzat e djalit dhe marrin pjesën e mbetur pas pjesës së vajzave apo vajzave të djalit.



Vajza një të dytën, vajza e djalit një të gjashtëtën, motrat një të tretën. Muhamedi s.a.v.s. ka thënë: **“Motrat vërinë së bashku me vajzat në bashkëpjesëmarrje.”**

TRASHËGIMIA E MOTRËS NGA BABAI SIPAS SË DREJTËS TRASHËGIMORE ISLAME

Motrat prej babai trashëgojnë në 6 opsione:

Opsioni i parë


Mbulimi:

- Mbulohen me ekzistencën e paraardhësit ose pasardhësit mashkull trashëgues;
- Mbulohen me ekzistencën e vëllait prej nëne e babai;
- Mbulohen me ekzistencën e motrës prej nëne e babai, nëse ajo mbështetet me vajzën ose vajzën e djalit sepse ajo në këtë rast zë pozitën e vëllait prej nëne e babai. Ajo ka përparësi ndaj vëllait prej babai dhe motrës prej babai kur ajo mbështetet me të tjerë.;
- Mbulohen me ekzistencën e dy motrave prej nëne e babai, vetëm nëse me to, në gratën e tyre është një vëlla prej babai i cili i mbulon ato. Pjesa e mbetur ndahet mes tyre, ku mashkulli merr dyfishin e femrave.
- Nëse i vdekuri lë pas dy motra nga nëna e babai, motra nga babai dhe një vëlla nga babai, dy motrat prej nëne e babai marrin dy të tretat dhe pjesa e mbetur ndahet mes motrave dhe vëllait prej babai, ku mashkulli merr dyfishin e femrave.

Opsioni i dytë

Motra prej babait trashëgon $1/2$ (një të dytën) atëherë kur:

- Nuk ka lozë të poshtme;
- Nuk ka lozë të epërme mashkullore;
- Nuk ka motra tjera prej babait që i përzihet në trashëgimi;
- Nuk ka vëlla prej babait.




Burri një të dytën, motra nga babai një të dytën.

Opsioni i tretë

Trashëgojnë dy të tretat kur:

- Janë dy apo më shumë;
- Nuk ka lozë të poshtme;
- Nuk ka lozë të epërme mashkullore;
- Nuk kanë vëlla nga babi.




Motrat prej nëne një të tretën, motrat prej babai dy të tretat.

Opsioni i katërt

Trashëgon një të gjashtën kur:


- është vetëm me një motër prej nëne e babai, me të cilën e plotëson dy të tretën;
- nuk ka vëlla nga babai.



Një të katërtën gruaja, një të dytën motra e vërtetë, një të gjashtën motra prej babai, tepicën motra e vërtetë.

Opsioni i pestë

Trashëgojnë bashkë me të tjerë (asaba meal gajri), kur është një apo më shumë dhe bashkë me to është edhe një vëlla prej babai. Në këtë rast mashkulli merr sa dyfishi i femrës.




Një të tretën motra nga babai, dy të tretat vëllai nga babai.

Opsioni i gjashtë

Trashëgojnë bashkë me të tjerë (asaba meal gajri) kur:

- me njëerën apo më shumë është një vajzë apo vajzë e djalit. Në këtë rast ato marrin pjesën që mbetet pas ndarjes së pjesës së vajzës apo vajzës së djalit.



Vajza një të dytën dhe dy motrat një të katërtën në formën asaba meal gajri, nëna një të gjashtë, gruaja një të tetën.

TRASHËGIMIA E VAJZËS SË DJALIT

Vajzat e djalit trashëgojnë në pesë opsione:

Opsioni i parë


Vajzat e djalit nuk trashëgojnë kur ekziston djali i drejtpërdrejtë.

Opsioni i dytë

Vajzat e djalit nuk trashëgojnë kur ekzistojnë dy apo më shumë vajza të drejtpërdrejta vetëm se nëse me to ekziston një djalë djali në nivelin e tyre apo më poshtë se ato një shkallë i cili në këtë rast i mbulon dhe trashëgojnë prej tij.

Opsioni i tretë

Nëse është vetëm dhe nuk ekziston djali i vërtetë merr gjysmën.




Vajza e djalit një të dytën, nëna një të gjashtëtën, baba dy të tratat.

Opsioni i katërt

Vajzat e djalit marrin dy të tretat kur:

- janë dy e më shumë;
- nuk ekziston djali i vërtetë;
- nuk ka djalë të djalit.




Dy vajzat e djalit dy të tretat, babai një të tretën.

Opsioni i pestë

Trashëgon një të gjashtën kur:

- është një apo më shumë dhe janë në koalicion (asaba) së bashku me vajzën e drejtpërdrejtë si plotësim i dy të tretave vetëm nëse me to është edhe një djalë në nivelin e tyre i cili i mbulon ato dhe marrin së bashku. Kështu, pjesa e mbetur pas pjesës së vajzës së drejtpërdrejtë ndahet mes tyre ku mashkulli merr dyfishin e femrave (vajza e djalit nuk trashëgon).

Nëse i vdekuri lë pas vetes vajzën, vajzën e djalit dhe gjyshin.




Vajza $\frac{1}{2}$ farz, vajza e djalit $\frac{1}{6}$ pjesë farz, gjyshi $\frac{1}{3}$ pjesë teasibë.

Vajza trashëgon $\frac{1}{2}$ (një të dytën), ndërsa vajza e djalit $\frac{1}{6}$ (një të gjashtën), që së bashku të plotësojnë $\frac{2}{3}$ (dy të tretat). Zoti i Lartmadhëruar a ka thënë:

“...nëse janë (trashëgimtare) vetëm femra, dy e më shumë, atyre u takojnë dy të tretat e pasurisë që trashëgohet...”

TRASHËGIMIA E GJYSHIT NGA BABAI

Gjyshi mbulohet dhe nuk trashëgon nëse ekziston babai.



Kur mungon baba, gjyshi zë vendin e babait.

Trashëgimia e gjyshit (baba i babës) vërtetohet me konsensus.

Transmetohet nga Umran ibën Hasin se një person i kishte shkuar Muhamedit a.s. dhe e kishte pyetur: Djali i djalit tim ka vdekur, ç'pjesë të trashëgimisë më takon mua?

Muhamedi a.s. i tha: Një e gjashta.

Kur ai po largohej, Muhamedi a.s. e thirri dhe i tha: Ti ke edhe një të gjashtënjë tjetër.

Kur u largua, përsëri e thirri dhe i tha: Një e gjashta tjetër është dhuratë.

(Transmetojnë Ahmed, Ebu Davudi dhe Tirmidhiu i cili e vlerëson si të saktë)

- Nëna e babait nuk trashëgon kur ekziston babai, sepse ajo lidhet me të dhe trashëgon me ekzistencën e gjyshit.
- Nëse babai ekziston, ai i pengon nga trashëgimia vëllezërit dhe motrat prej nëne e babai si dhe vëllezërit e motrat prej babai, përderisa këta nuk mbulohen nga gjyshi.


Ebu Hanife ka thënë: “Ata (vëllezërit dhe motrat prej nëne e babai si dhe vëllezërit e motrat prej babai) mbulohen nga gjyshi ashtu si mbulohen nga babai, sepse s’ka dallim mes tyre”.

Gjyshi ka tri opsione:

Opsioni i parë

Trashëgon një të gjashtën farz kur:

- nuk është baba i të vdekurit
- ka trashëgimtarë të lozes së poshtme.




Djali pesë të gjashtat, gjyshi një të gjashtat.

Opsioni i dytë

Trashëgon pjesën e papërcaktuar nëse i vdekuri nuk e ka:

- babanë;
- lozën e poshtme.




Gruaja një të katërtën, gjyshi tri të katërtat.

Opsioni i tretë

Gjyshi trashëgon pjesën e përcaktuar farz dhe të papërcaktuar teasibë kur i vdekuri:

- Nuk e ka babanë;
- ka lozë të poshtme të gjinisë femërore.



Gjyshi një të dytën, vajza një të dytën.

TRASHËGIMIA E GJYSHEVE

Gjyshe e vërtetë konsiderohet:

- Nëna e nënës,
- nëna e babait,
- nëna e gjyshit (nëna e babait të babait).

Kur i vdekuri e ka nënën gjallë gjyshja nuk trashëgon.

Kur mungon nëna, atëherë vjen në pyetje që gjyshja të trashëgoj.

Kjo do të thotë se nëna e mbulon gjyshen.

Argument për këtë është thënia e Pejgamberit s.a.v.s.:

“Jepuani gjysheve një të gjashtën”.

Gjyshet e vërteta trashëgojnë në tri opsione:

Opsioni i parë

Gjyshja mbulohet (përfashtohet) në këto raste:

Nëna i mbulon gjyshet, që do të thotë se kur të jetë nëna, gjyshet nuk trashëgojnë, as gjyshja e atësisë, as ajo e mëmësisë.

Kur i vdekuri e lë babanë, atëherë babai e mbulon gjyshen e atësisë, por nuk e mbulon gjyshen e mëmësisë.

Gjyshja më e afërt e mbulon gjyshen më të largët.

Babai i mbulon gjyshet e atësisë, ndërsa nuk i mbulon gjyshet e mëmësisë, sepse gjyshet e mëmësisë nuk ndërlidhen me të.

Babai i mbulon gjyshet, të cilat i paraprijnë atij (pra të atësisë), që do të thotë se kur të jetë babai, ai e mbulon gjyshen nga babai, por nuk e mbulon gjyshen nga nëna.

Opsioni i dytë


Gjyshja e afërt, nga cilado anë qoftë, e mbulon të largëtën, si p.sh. nëna e nënës e mbulon nënën e nënës së nënës, gjithashtu edhe nënën e babait të babait.

Opsioni i tretë


Nëse i vdekuri lë pas vetes gjyshen (nënë e nënës), ajo trashëgon $1/6$ (një të gjashtë).

Nëse i vdekuri lë pas vetes gjyshen (nënë e babait), ajo trashëgon $1/6$ (një të gjashtë).


Nëse i vdekuri lë pas vetes që të dyja, gjyshet e vërteta (nënë e nënës dhe nënën e babait), atëherë që të dyja gjyshet e trashëgojnë së bashku $1/6$ (një të gjashtë), si p.sh. nëna e nënës dhe nëna e babait.



Nëna e nënës kur të jetë e vetme, trashëgon një të gjashtë.



Nëna e nënës dhe nëna e babës që të dyja së bashku trashëgojnë një të gjashtë.



Nëna e babës kur të jetë e vetme trashëgon një të gjashtë.

TRASHËGIMTARËT “ASABA”

Trashëgimtarë “Asaba” janë trashëgimtarët me të drejtë të papërcaktuar dhe me të drejtë bashkëpjesëmarrjeje.

Trashëgimtarët për nga forma e trashëgimisë ndahen në:

1. **Trashëgimtarë të specifikuar për të trashëguar formën përcaktuar AS-HABUL FURUD me fjalë tjera Farzmarrësit; dhe**
2. **Trashëgimtarë të caktuar për të trashëguar në formën e papërcaktuar ASABA.**

Asaba do të thotë lidhje e fortë.

Asaba janë bijtë e personit dhe të afërmit e tij nga ana e babait. Janë quajtur kështu sepse ata shtrëngojnë fort njëri-tjetrin dhe bëhen koalicion.

Me “**Asaba**” nënkuptohen personat që marrin pjesën e mbetur nga trashëgimia, pasi që trashëgimtarët farzmarrës të kenë marrë pjesën e tyre. Nëse, pas kësaj nuk mbetet ndonjë pjesë, atëherë trashëgimtarët Asaba nuk trashëgojnë sepse pjesa e përcaktuar ka përparësi ndaj pjesës së papërcaktuar.

Çdo trashëgimtarë “asaba” mund të mos trashëgoj, përpos birit të të vdekurit i cili edhe pse është “asaba”, ai nuk mbulohet nga trashëgimia në asnjë rast por trashëgon.

Asaba janë trashëgimtarët të cilët renditen në rend për të trashëguar, nëse nuk ka asnjë person farzmarrës. Muhamedi s.a.v.s. ka thënë: “**Jepuni personave pjesën e përcaktuar (farz), ndërsa pjesën që mbetet, i jepet mashkullit më të afërt.**” (Buhariu dhe Muslimi)

Trashëgimtarët me të drejtë të papërcaktuar (asaba) ndahen në:

1. **Asaba bi nefsihi** – koalicionet me veten (gjininë) e tyre;
2. **Asaba bi gajrihi** – koalicionet prej të tjerëve;
3. **Asaba meal gajri** – koalicionet me të tjerë.

1. Koalicion me veten e tyre (të gjinisë vetanake) janë:

Asaba bi nefsihi – koalicion me veten është çdo mashkull që në lidhjen e tij me të vdekur nuk hyn asnjë femër.

Asaba bi nefsihi kufizohen në katër kategori:

1. **djemtë** – që quhen dega e të vdekurit;
2. **baballarët** – që quhen rrënja e të vdekurit;
3. **vëllezërit** – që quhen pjesë e babait;
4. **xhaxhallarët** – që quhen pjesë e gjyshit.




Ata që janë në koalicion me veten e tyre në bazë të kategorive të tyre trashëgojnë sipas renditjes së mëposhtme:

Kategoria e parë

Në kategorinë e parë hynë djemtë, që përfshijnë djemtë, djemtë e djemve e poshtë. Kjo kategori i mbulon të gjitha të tjerat, pra kur ekzistojnë djemtë, nuk trashëgojnë kategoritë tjera si babai, vëllezërit, etj.


Tash do t'i ilustrojmë dy raste të trashëgimisë asaba të kategorisë së parë:

Rasti i parë, kur trashëgon baba dhe një djalë:



Në këtë rast, baba trashëgon $\frac{1}{6}$ farz, kurse djali trashëgon tërë pjesën e mbetur teasibë, pra $\frac{5}{6}$.

Rasti i dytë, kur trashëgon baba dhe pesë djemtë.



Kategoria e dytë

Nëse nuk ekziston ana e djemve, trashëgimia apo ajo që mbetet kalon në anën e **baballarëve që përfshin babanë, gjyshin e vërtetë e sipër.**

Kategoria e tretë

Nëse nuk ekziston asnjë i gjallë nga ana e baballarëve që meriton trashëgiminë apo atë që mbetet prej saj, trashëgimia kalon në anën e **vëllazërisë** që përfshin vëllezërit prej nëne e babai, vëllezërit prej babai, fëmijët e vëllait prej nëne e babai dhe fëmijët e vëllait prej babai e ata që zbresin prej të dyve.

Kategoria e katërt

Nëse nuk ka asnjë të gjallë nga ana e babës e përpjetë, nga ana e djalit e teposhtë nga ana e vëllezërve, atëherë trashëgimia apo ajo që mbetet prej saj kalon në anën e **xhaxhallarëve** pa dallim mes xhaxhallarëve të vetë të vdekurit apo xhaxhallarëve të babait apo gjyshit të tij.

Xhaxhallarët e vetë të vdekurit kanë përparësi ndaj xhaxhallarëve të babait dhe këta ndaj xhaxhallarëve të gjyshit e kështu me radhë.

- Nëse ekzistojnë disa persona nga i njëjti nivel, më shumë të drejtë për trashëgiminë ka ai që është më i afërt me të vdekurin.
- Nëse ekzistojnë disa persona që kanë të njëjtën lidhje me të vdekurin sipas anës dhe nivelit, më të drejtë për trashëgiminë ka ai që e ka afërsinë më të fortë.
- Nëse i vdekuri lë persona të barabartë në lidhjen e tij me ta sipas anës, nivelit dhe forcës së lidhjes, ata e meritojnë të tërë trashëgiminë në mënyrë të barabartë sipas numrit të tyre.

Ky është edhe kuptimi i thënies së juristëve: **“Përparësia në afërsinë (asaba) me veten e tyre merret sipas anës, -nëse janë të njëjtë sipas nivelit, nëse janë të barabartë sipas forcës nëse janë të njëjtë në nivel, anë dhe forcë, e meritojnë të gjithë trashëgiminë në mënyrë të barabartë e ajo ndahet sipas numrit të tyre”.**

2. Koalicioni prej të tjerëve (gjinisë tjetër)

Koalicioni prej të tjerëve, janë femrat të cilat marrin gjysmën e trashëgimisë farz kur janë të vetme, dy të tretat nëse ka një motër apo më tepër, e nëse me të apo me to është një vëlla, atëherë të tërat mbulohen nga ai (asaba).

Koalicion prej të tjerëve janë katër llojesh:

1. vajza ose vajzat;
2. vajza ose vajzat e djalit;
3. motra ose motrat prej nëne e babai;
4. motrat ose motrat prej babai.

Secili nga këta katër grupe formojnë koalicion (asaba) prej të tjerëve që është vëllai. Në këtë rast, trashëgimia ndahet mes tyre, ku mashkulli merr dyfishin e femrës.

3. Koalicion me të tjerët (të njëjtës gjini por të rangut tjetër)

Çdo femër që ka nevojë për një tjetër femër për t'u bërë e afërt (asaba). Koalicioni me tjerët kufizohet vetëm në dy femra që janë:

1. Motra apo motrat prej nëne e babai me vajzën apo vajzat e djalit.

2. Motra apo motrat prej babai me vajzën apo vajzat e djalit. Ato marrin pjesën që mbetet nga trashëgimia pas ndarjes së pjesëve farz (të përcaktuar).

Kandidatët e nominuar për trashëgimi të papërcaktuar

Trashëgimtarët “asaba” ndahen në dy grupe:

1. Trashëgimtarët asaba (koalicioni) sipas gjakut
2. Trashëgimtarët asaba (koalicioni) prej ndonjë shkaku.

1. Trashëgimtarët asaba (Koalicionin) sipas gjakut e shpjeguar më herët.

2. Trashëgimtarët asaba (Koalicionin) prej ndonjë shkaku. I afërmi prej ndonjë shkaku është skllavi i liruar, mashkull qoftë apo femër. Nëse nuk ekziston një i tillë, trashëgimia i takon të afërmeve të tij.

SHTIMI APO PAKËSIMI I PJESËS TRASHËGIMORE (EL-AULI)

Trashëgimtarët farz, të cilët i plotësojnë kushtet, patjetër duhet të marrin pjesën e tyre që u takon. Por, mund të ndodhë që disa trashëgimtarë ta plotësojnë tërë masën trashëgimore dhe një trashëgimtar farz të mbetet pa trashëgimi. Mirëpo në rregullat e trashëgimisë një gjë e tillë nuk lejohet, sepse farzmarrësi nuk mund të largohet nga trashëgimia, kurse trashëgimtari asaba po. Për këtë arsye, duhet bërë zgjidhje, e zgjidhja bëhet duke i rritur pjesët trashëguese dhe duke zvogëluar hiset e secilit trashëgimtar, me qëllim që të mos dëmtohet asnjë trashëgimtar, e kështu vijmë deri te rregulli i quajtur “Aul”.

El Aul në gjuhën arabe do të thotë ngritje, por mund të vijë edhe me kuptimin *anim kah padrejtësia*.

Me El Aul kuptohet:

- Shtimi i pjesëve të trashëgimisë për shkak të numrit të vogël të trashëgimtarëve; ose
- Pakësimi i pjesëve për shkak të numrit të madh të trashëgimtarëve të caktuara të trashëgimisë së personave që marrin pjesë të caktuara (farz).

Auli nuk ka ndodhur në kohën e Pejgamberit s.a.v.s. e as në kohën e Ebu Bekri Siddikut. I pari i cili e ka praktikuar emëruesin e përbashkët është Umeri r.a..

Rastet kur nuk ka nevojë për Aulin dhe kur ka nevojë për Aulin

Nëse e vdekura lë pas vetes burrin dhe motrën:

- Burrit i takon $\frac{1}{2}$;
- Motrës i takon $\frac{1}{2}$.

Këtu nuk ka nevojë të mendohet për ngritje, sepse çështja veç është zgjidhur, një pjesë e merr burri dhe një pjesë e merr motra.

Rasti në të cilin ka ndodhur auli është rasti kur një sahabije vdes dhe lë pas vetes burrin dhe dy motra. Burrit i takonte $\frac{1}{2}$ dhe motrave u takonin $\frac{2}{3}$. Pjesa farz ishte më e madhe se sa pjesët trashëguese. Burri me këmbëngulje kërkonte $\frac{1}{2}$ e cila i takonte. E edhe motrat me këmbëngulje kërkonin $\frac{2}{3}$ që u takonin. Nëse i jepeshin burrit $\frac{1}{2}$, atëherë nuk mbeteshin $\frac{2}{3}$ për motrat. Nëse u jepeshin motrave $\frac{2}{3}$ nuk mbetej $\frac{1}{2}$ për burrin. Umeri r.a. u thotë se nuk po e di se cilit prej tyre t'ua pakësojë hisen farz. Pastaj Umeri r.a. u thotë: Pritni deri sa të konsultohem me sahabët. Konsultohet me sahabët, e posaçërisht me Zejd bin Thabitin i cili thotë: **Gjeni një emërues të përbashkët të hiseve dhe secili merreni masën e merituar pa u dëmtuar asnjëri.** Pastaj sahabët e tjerë e pëlqyen këtë mendim. Abas ibn Abdul Mutalibi e këshilloi të merrte për bazë pakësimin proporcional. Nga disa thuhet se këtë e ka bërë Aliu r.a. dhe nga disa thuhet se Zejd ibën Thabiti.

Pastaj, me këtë janë pajtuar të gjithë ekspertët e jurisprudencës islame, ndërsa Auli ka hyrë në fuqi të shariatit islam nëpërmjet ixhmait dhe këtë nuk e ka kundërshtuar asnjëri prej sahabëve.

Çështjet në të cilat mund të hyjë auli janë ato që kanë për emërues numrat: 6, 12 dhe 24.

Gjashta mund të bëhet shtatë, tetë, nëntë, dhjetë dhe dymbëdhjeta mund të bëhet trembëdhjetë, pesëmbëdhjetë dhe shtatëmbëdhjetë. Njëzet e katra mund të bëhet njëzet e shtatë. Ndërsa çështjet në të cilat nuk mund të hyjë auli janë ato që kanë për emërues numrat: 2, 3, 4 dhe 8.

Mënyra e zgjidhjes së çështjeve të aulit:

Duhet të dihet emëruesi e çështjes dhe pjesët që i takon secilit person që merr pjesë të caktuara. Emëruesi të mos llogaritet ndërsa pjesët e tyre të mblidhen, shuma e dalë të bëhet emërues dhe pastaj trashëgimia të ndahet mbi këtë emërues. Në këtë mënyrë, secilit do t'i pakësohet pjesa në bazë të numrit të pjesëve që i takojnë. Kështu evitohet padrejtësia.

Shembull kemi rastin të cilën e përmendem më herët kur një grua vdes, e lë burrin dhe dy motra prej nëne e babai.

Emëruesi i përbashkët i kësaj çështjeje është gjashtë: burrit i takon gjysma që është tre dhe dy motrave dy të tretat që është katër.

Shuma është shtatë e mbi këtë emërues ndahet trashëgimia.

TRASHËGIMIA E FAREFISIT

Të parët që trashëgojnë janë farzmarrësit, pastaj trashëgimtarët asaba. Nëse nuk janë këta, atëherë në rend vijnë trashëgimtarët farefis.

Farefis konsiderohet çdo i afërm i cili nuk është trashëgimtarë farzmarrës e as asaba.

Për çështjen e të drejtës trashëgimore të tyre, dijetarët kanë dhënë mendime të ndryshme:

- Disa kanë thënë që farefisi nuk merr trashëgimi, por pasuria i kthehet **buxhetit të shtetit**.
- Disa kanë thënë që nëse nuk ka farzmarrës dhe asaba, atëherë trashëgon **farefisi**.

Farefisi është katër llojesh, ku disa kanë përparësi ndaj disa të tjerëve. Ata renditen si më poshtë:

Lloji i parë:

- Fëmijët e vajzave dhe pasardhësit e tyre, dhe
- fëmijët e vajzave të linjës së djalit.

Lloji i dytë:

- Gjyshi e gjyshja nga nëna dhe paraardhësit e tyre.

Lloji i tretë:

- Djemtë e vëllezërve prej nëne, fëmijët e tyre sado që zbresin,
- fëmijët e motrave prej nëne e babai apo prej njërit prej tyre sado që zbresin,
- vajzat e vëllezërve prej nëne e babai apo prej njërit prej tyre sado që zbresin,
- vajzat e djemve të vëllezërve prej nëne e babai apo prej babai sado që zbresin dhe fëmijët e tyre sado që zbresin.

Lloji i katërt: Ky lloj përfshin gjashtë grupe, dhe renditjen e tyre do ta bëjmë sipas rëndësisë/përparësisë ndaj njëri-tjetrit (të epërmit i eliminojnë të mëposhtmit):

1. Xhaxhallarët prej nëne, hallat prej nëne, dajat dhe tezet prej nëne e babai apo njërit prej tyre.

2. Fëmijët e atyre që i përmendëm më lart. Vajzat e xhaxhallarëve prej nëne e babai apo prej babai, vajzat e djemve të tyre sado që zbresin dhe fëmijët e këtyre vajzave sado që zbresin.

3. Xhaxhallarët e babait prej nëne, hallate babait prej nëne, dajat dhe tezet e babait prej nëne e babai apo njërit prej tyre. Xhaxhallarët e nënës, hallat e nënës, dajat dhe tezet nënës prej nëne e babai apo njërit prej tyre.

4. Fëmijët e atyre që u përmendën më lart sado që zbresin. Vajzat e xhaxhallarëve të babait të të vdekurit prej nëne e babai apo prej babai dhe vajzat e djemve të tyre sado që zbresin. Fëmijët e këtyre vajzave që u përmendën sado që zbresin.

5. Xhaxhallarët e babait të babait nga nëna, xhaxhallarët e babait të nënës dhe hallat, dajat dhe tezet e atyre të dyve prej nëne e babai apo njërit prej tyre. Xhaxhallarët e nënës së nënës (gjyshes nga nëna) dhe nënës së babait të tij, hallat e nënës së nënës, dajat dhe tezet nënës së nënës prej nëne e babai apo njërit prej tyre.

6. Fëmijët e atyre që u përmendën më lart sado të zbresin, vajzat e xhaxhallarëve të babait të babait të të vdekurit prej nëne e babai apo vetëm prej babai, vajzat e djemve të tyre sado të zbresin, fëmijët e atyre vajzave që u përmendën këtu sado të zbresin.

Në trashëgiminë e farefisit duhet shikuar pikat si në vijim:

Pika e parë:

Në llojin e parë të të afërmve, të parët në trashëgimi janë ata që janë më afër me të vdekurin në **shkallë afërsie**.

- Nëse janë të barabartë në shkallë afërsie, fëmija i personit farzmarrës ka përparësi ndaj fëmijës së të afërmve të tjerë.
- Nëse përsëri janë të barabartë në shkallë afërsie dhe mes tyre nuk ka fëmijë të personit farzmarrës apo të gjithë lidhen njëjtë me trashëgimlënësin, atëherë të gjithë marrin pjesë në trashëgimi.

Pika e dytë:

Në llojin e dytë të të afërmve, përparësi në trashëgimi ka ai që është më i afërti **me të vdekurin**.

- Nëse të tërë personat e llojit janë të barabartë në shkallë, përparësi ka ai që lidhet me personin farzmarrës (që merr pjesë të caktuar).
- Nëse janë të barabartë dhe nuk ka mes tyre person që lidhet me personin farzmarrës (që merr pjesë të caktuar), apo të tërë lidhen me këtë person, atëherë: nëse kanë të njëjtën rang afërsie p.sh. të jenë të gjithë nga ana e babait, marrin të gjithë pjesë në trashëgimi.
- Nëse dallojnë, atëherë të afërmit nga babai marrin dy të tretat dhe të afërmit nga nëna marrin një të tretën.

Pika e tretë:

Në llojin e tretë të të afërmeve, përparësi në trashëgimi kanë ata që janë më të afërm me të vdekurin për nga **shkalla e afërsisë**.

- Nëse janë të barabartë në shkallë dhe mes tyre ka ndonjë fëmijë të ndonjë lidhësi (asib), atëherë ky ka më përparësi ndaj fëmijës së të afërmit. Përndryshe, përparësia i jepet atij që ka lidhjen më të fortë me të vdekurin.
- Kush e ka lidhjen me anë të babait dhe nënës ka përparësi nga ai që lidhet vetëm me anë të babait, e kush lidhet vetëm me anë të babait ka përparësi ndaj atij që lidhet vetëm me anë të nënës. Nëse janë të barabartë në shkallë dhe në forcën e afrimitetit, marrin të gjithë pjesë në trashëgimi.

Pika e katërt:

Në grupin e parë të llojit të katërt, grupi i babait, që janë xhaxhallarët e të vdekurit nga nëna dhe grupi i nënës që janë dajallarët dhe tezet,

- Nëse njëri prej tyre është i vetëm, atëherë përparësi i jepet atij që ka afërsinë më të fortë.
- Kush lidhet me anë të dy prindërve, ai ka më përparësi ndaj atij që lidhet vetëm me anë të babait e ai që lidhet me anë të babait ka më përparësi ndaj atij që lidhet me anë të nënës. Nëse janë të barabartë në afërsi, marrin të gjithë pjesë në trashëgimi.
- Nëse të dy grupet bashkohen, pra të babait dhe nënës, të afërmit nga babai marrin dy të tretat dhe të afërmit nga nëna marrin një të tretën. Pjesa e secilit ndahet siç është përmendur më sipër. Dispozitat e kësaj çështjeje zbatohen edhe për grupin e tretë dhe të pestë të llojit të katërt.

Pika e pestë:

Në grupin e dytë të llojit të katërt, përparësi i jepet më të afërmit në shkallë afërsie ndaj më të largët, edhe nëse dallon nga rangu.

- Nëse janë të barabartë në shkallë afërsie apo në rang, nëse janë fëmijë lidhësi (asib) apo fëmijë të ndonjë të afërmi, përparësi i jepet më të afërmit.
- Nëse dallojnë, përparësi i jepet fëmijës së lidhësit ndaj të afërmit tjetër.
- Nëse rangu ndryshon, dy të tretat i marrin të afërmit nga babai dhe një të tretën të afërmit nga nëna. Pjesa e secilit ndahet siç është përshkruar më parë dhe dispozitat e kësaj pike zbatohen edhe në grupin e katërt dhe të gjashtë të llojit të katërt.

Pika e gjashtë:

Llojshmëria e anëve të lidhjes nuk ndikon në trashëgimtarin që është prej të afërmeve vetëm në rast se ndryshon rangu, pra a lidhet me anë të babait apo nënës.

Pika e shtatë:

Në ndarjen e trashëgimisë mes të afërmeve, mashkullit i jepet sa dyfishi i femrave.

TRASHËGIMIA E FËMIJËS NË BARKUN E NËNËS

Mund të ndodh që një trashëgimtar në atë moment ende nuk ka lindur por është në barkun e nënës.

Kur fëmija lind nga nëna e tij, mund të dalë:

- ose i gjallë,
- ose i vdekur.

Nëse lind i gjallë, mund të trashëgojë apo të trashëgohet nga të tjerët, sepse transmetohet nga Ebu Hurejra se Profeti (a.s.) ka thënë: “**Nëse fëmija lind i gjallë, ai trashëgohet**”.

Shenjat e jetës janë: zëri, frymëmarrja, teshtima, etj.

- Nëse lind i gjallë, në bazë të cilësisë trashëgon,
- e nëse lind i vdekur, konsiderohet sikurse të mos ishte fare.

Por, nëse lind i gjallë dhe pas disa sekondave vdes, ai në rend të parë trashëgon, e pastaj trashëgohet. Nga kjo mund të kuptohet se kushtet e të drejtës për të trashëguar fëmija në barkun e nënës janë:

E para: Që në momentin e vdekjes së atij, nga i cili trashëgohet, të jetë fëmija i gjallë në barkun e nënës.

E dyta: Që fëmija të lindë i gjallë, e kjo do të thotë se të ketë të drejtë pronësie, sepse i linduri i vdekur nuk ka të drejtë pronësie.

Sa i përket kushtit të parë, foshnja në bark të nënës, maksimumi i afatit të tij duhet të qëndrojë dy vjet.

Ndërsa, sa i përket kushtit të dytë, jeta apo gjallëria e foshnjës, fuqizohet në atë mënyrë që ai të klithë, të marrë frymë, të qajë ose të thithë, dhe çfarëdo lëvizje që argumenton se ai ka lindur i gjallë, e në atë moment ai trashëgon, e pastaj (nëse vdes) trashëgohet.

Argument për këtë kemi thënien e Pejgamberit s.a.v.s.

“Kur të klith foshnja (e vdes), falet namazi i xhenazes dhe pastaj trashëgohet”.(*Transmeton Nesaiju dhe Tirmidhiu*)

Foshnja në bark të nënës mund të jetë:

1. Foshnje, e cila nuk ka kurrfarë të drejtë të trashëgimisë, në çfarëdo mënyre, pa marrë parasysh a është mashkull apo femër.
2. Foshnje, e cila trashëgon si djalë apo vajzë në formën farzmarrjeje, e jo në diçka tjetër.
3. Foshnje, e cila mund të trashëgojë në mënyra të shumta.
4. Foshnje, e cila trashëgon vetëm në një mënyrë të caktuar, pa marrë parasysh a është femër apo mashkull.
5. Foshnje, e cila trashëgon e vetme dhe nuk ka trashëgimtar pas saj.

Sa i përket rastit të parë: Foshnje, e cila nuk ka kurrfarë të drejtë të trashëgimisë, në çfarëdo mënyre, pa marrë parasysh a është mashkull apo femër.

Që në momentin e vdekjes së atij nga i cili trashëgohet, të jetë fëmija i gjallë në barkun e nënës.

Bëhet ndarja e pjesëve trashëguesë, pa pritur lindjen e saj, sepse ajo në esencë nuk trashëgon në asnjë mënyrë. P.sh. i vdekuri lë pas vete gruan dhe babanë, dhe nënën që është shtatzënë por jo me babanë e tij. Nëse foshnja lind, ai do të jetë vëlla prej nënës, e ai është i mbuluar prej babait, kështu që trashëgimia ndahet kështu: grua e merr 1/4 (një të katërtën), nënës i takon 1/3 (një e treta) dhe pjesa tjetër babait.

Sa i përket rastit të dytë: Foshnje, e cila trashëgon si djalë apo vajzë në formën farzmarrjeje, e jo në diçka tjetër.

Që fëmija të lindë i gjallë, e kjo do të thotë se të ketë të drejtë pronësie, sepse i linduri i vdekur nuk ka të drejtë pronësie.

Trashëgimtarët marrin hiset e tyre, ndërsa stopohet pjesa për fëmijën në bark të nënës, ndërsa, nëse ai lind i gjallë, i jepet hisja, nëse jo, atëherë pjesa e mbetur u kthehet trashëgimtarëve në bazë të gjendjes fillestare. P.sh., nëse i vdekuri lë gruan, axhën, dhe gruan e vëllait e cila është shtatzënë, ndarja bëhet kështu:

Gruaja merr 1/4 (një të katërtën), ndërsa 3/4 (tri të katërtat) stopohen dhe pritet deri sa të lind foshnja. Nëse lind djalë e merr pjesën e mbetur, në këtë rast 3/4, sepse foshnja është djali i vëllait, e ai ka përparësi nga axha. Nëse lind vajzë, atëherë pjesën e mbetur e merr axha, sepse ai ka përparësi,

meqë vajza e vëllait është dhevil erham (farefis), e axha ka përparësi nga farefisi.

Sa i përket rastit të tretë: Foshnje, e cila mund të trashëgojë në mënyra të shumta.

Nëse foshnja do të mund të trashëgonte në të gjitha mënyrat, atëherë ndahet pjesa sa më e madhe e mundshme, sepse stopimi i pjesës për mashkull është më e mirë dhe më e madhe se stopimi i pjesës për femër.

Shembull: Nëse i vdekuri lë: gruan që është shtatzënë, babanë dhe nënën. Po të lindte foshnja djalë, ai është biri i të vdekurit, atëherë ndarja do të bëhej kështu: Gruaja merr $\frac{1}{8}$ (një të tetën), babait i takon $\frac{1}{6}$ (një e gjashta) dhe nënës $\frac{1}{6}$ (një e gjashta), atëherë djali e merr pjesën tjetër ($\frac{18}{24}$), sepse emëruesi i përbashkët i këtij rasti është 24.

24 Pjesë

Gruaja $\frac{1}{8}$ 3 Pjesë Farz

Babai $\frac{1}{6}$ 4 Pjesë Farz

Nëna $\frac{1}{6}$ 4 Pjesë Farz

Djali nga shtatzënia 13 Pjesë Teasibë

Po të lindte foshnja femër, ajo është vajza e të vdekurit, atëherë ndarja do të bëhej kështu:

24 Pjesë

Gruaja $\frac{1}{8}$, 3 Pjesë Farz

Babai, 5 Pjesë Farz + Teasibë

Nëna $\frac{1}{6}$, 4 Pjesë Farz

Vajza nga shtatzënia $\frac{1}{2}$, 12 Pjesë Farz

Disa specifika të trashëgimisë së fëmijës

Fëmija nuk trashëgon vetëm nëse lind një vit pas datës së vdekjes apo ndarjes mes nënës dhe babait të tij.

Fëmijës në bark i ndalet pjesa më e madhe që mund të meritojë duke marrë në konsideratë gjininë e tij.

Nëse një burrë vdes dhe lë gruan e tij apo gruan që është në pritje pas divorcit, fëmija që ajo ka në bark nuk trashëgon prej tij vetëm nëse ai është i gjallë në më të shumtën 365 ditë që nga dita e vdekjes apo ndarjes. Fëmija që është në barkun e nënës nuk trashëgon tjetër person përveç babait të tij vetëm në dy raste:

1. Të lindë i gjallë në më të shumtën 365 ditë nga dita e vdekjes apo ndarjes nëse nëna e tij është në kohën e pritjes prej vdekjes apo divorcit dhe i ati vdes gjatë kësaj periudhe.
2. Të lindë i gjallë në më të shumtën 170 ditë nga dita e vdekjes së trashëguesit të tij nëse martesë është akoma e lidhur në momentin e vdekjes.

Nëse pjesa e lënë fëmijës është më e pakët se ajo që ai meriton, atij i jepet pjesa e mbetur që i është shpërndarë si shtesë trashëgimtarëve të tjerë. Nëse pjesa e lënë është më e madhe se ajo që meriton, pjesa e mbetur i jepet trashëgimtarëve të tjerë që e meritojnë.

TRASHËGIMIA E PERSONAVE TË PAGJETUR (HUMBUR)

Person i pagjetur quhet personi i zhdukur apo i humbur.

Në terminologji, **i pagjetur** quhet personi i zhdukur apo i humbur, për të cilin janë humbur gjurmët për ta ditur se a është i gjallë apo i vdekur. Kjo ndodh në rast të fatkeqësive, tragjedi, tërmete, vërshimeve, luftërave etj.

I pagjeturi mund të ketë pasur vet pasuri. Atëherë si të veprohet me pasurinë e tij: të trashëgohet apo jo? .

Në anën tjetër, **të pagjeturit** i takon trashëgimia prej ndonjë të afërmi, i cili vdes, kurse ai është i pagjetur. Në këtë rast a duhet të trashëgojë atë pjesë apo jo? Nga kjo që thamë, këtë temë e ndajmë në dy nëntituj.

1. Të trashëguarit e pasurisë së të pagjeturit

Rregull është që pasuria e të pagjeturit të mos trashëgohet, por i ruhet pasuria deri sa të vërtetohet gjendja e tij. Nëse gjendet, e merr pasurinë e tij. Nëse vërtetohet vdekja e tij me fakte, argumente dhe dëshmi, atëherë ndahet pasuria e tij tek të gjallët prej datës së vërtetimit të vdekjes së tij, e jo të humbjes së tij.

Ndërsa, nëse çështja e tij mbetet e hapur, pasuria mbetet në pronësi të tij deri sa të vendos gjyqi (kadiu në islam) për vdekjen të tij. Kur të vendoset, atëherë trashëgimia fillon prej datës së vendimit, e jo të humbjes së tij. Nëse ndonjëri vdes para kësaj date, ai nuk ka të drejtë të trashëgojë.

2. Trashëgimi i të pagjeturit prej të tjerëve

Sa i përket trashëgimisë së të pagjeturit prej të tjerëve, në esencë ai nuk trashëgon, sepse prej kushteve të trashëgimisë është jeta e vërtetë (të jetë gjallë ai që merr trashëgimi) në momentin e vdekjes së të trashëguarit. Mirëpo, duke pasur parasysh se ai (i pagjeturi) mund të jetë i gjallë, ai trashëgon në bazë të parimit të supozimit, që do të thotë se supozohet se ai është gjallë, pastaj trashëgimia e tij vendoset në dorë të ndonjë njeriu besnik deri sa të vërtetohet çështja e tij:

- Nëse gjendet i gjallë, ai e merr pjesën e tij,
- Nëse gjendet i vdekur, atëherë pjesa e tij u kthehet trashëgimtarëve paraprak.
- Ndërsa, nëse vazhdon të mbetet i pagjetur, atëherë ai nuk trashëgon nga pasuria e të tjerëve.

PARAQITJA E TË HUMBURIT (PAGJETURIT) PASI QË ËSHTË VENDOSUR SE AI ËSHTË I VDEKUR

Ndodhë që pas një kohe të gjatë, në bazë të rrethanave, në bazë të dëshmive, gjykata vendos përfundimisht se i pagjeturi është i vdekur, kështu që pjesa e tij u ndahet të tjerëve. Mirëpo, nëse ndodh që i pagjeturi të paraqitet i gjallë, atëherë ajo pjesë e trashëgimisë i kthehet atij, edhe nëse është shpërndarë te trashëgimtarët e tjerë. Kështu veprohet, nëse ajo pjesë e pasurisë nuk është shfrytëzuar. Mirëpo nëse është shpenzuar, atëherë ai (i pagjeturi i paraqitur) nuk mund të kërkojë kundërvlerën, sepse të tjerët kanë vepruar në bazë të vendimit të gjykatës. Për këtë arsye nuk ka të drejtë të kërkojë kundërvlerë.

MARRËVESHJET ME KOMPROMISE (ET TEHARUXH)

Et Teharuxh quhet kur trashëgimtarët pajtohen që disa prej tyre të heqin dorë nga pjesa e tyre e trashëgimisë në këmbim të diçkaje të caktuar, qoftë ajo nga trashëgimia ose jo.

Ujdia mund të jetë edhe mes dy trashëgimtarëve që njëri prej tyre të zërë vendin e tjetrit në pjesën që i takon në këmbim të një shume të hollash që i ofrohet. Kështu pra, nëse një prej trashëgimtarëve bie në ujdi me një tjetër, ai merr pjesën e tij dhe zë vendin e tij në trashëgimi. Kur njëri prej tyre bie në ujdi me tërë trashëgimtarët, atëherë, nëse atij i jepet diçka në këmbim nga vetë trashëgimia, pjesa e tij e trashëgimisë nga e cila ai hoqi dorë ndahet mes të tjerëve në bazë të pjesës që secilit i takon. Nëse atij i jepet diçka nga pasuria e trashëgimtarëve të tjerë dhe në kontratën e ujdisë nuk është përshkruar mënyra e ndarjes së pjesës së atij që ka dalë, ajo ndahet mes tyre në mënyrë të barabartë.

Dispozita e marrëveshjes me kompromis

Ajo është e lejuar kur ekziston dëshira. Tregohet se Abdurrahman ibën Aufi e kishte ndarë gruan e tij, Temadur bint Esbag Kelbija, gjatë sëmundjes së vdekjes. Ai vdiq kur ajo ishte në periudhën e pritjes. Pjesën e saj e trashëguan Uthmani me tre gra të tjera. Ata ranë në ujdi me të që t'i jepnin tetëdhjetë e tre mijë në vend të çerekut të një të tetës së saj. Thuhet që shuma ka qenë në dinarë e thuhet se ka qenë në derhemë.

TESTAMENTI ME MË SHUMË SE NJË E TRETA

Kur një njeri vdes dhe nuk lë pas vetes as trashëgimtarë apo person për të cilin ka pohuar prejardhjen e tij, lejohet që ai t'ia lërë testament një të huaji çfarëdo pjese të pasurisë së tij apo të tërën, pasi kufizimi me një të tretën është për shkak të ekzistencës së trashëgimtarëve, ku asnjëri prej tyre nuk gjendet në këtë rast.

TRASHËGIMIA E PERSONAVE TË CILËT VDESIN SË BASHKU NË AKSIDENT

“Garka dhe Hedma” quhen të gjithë trashëgimtarët që vdesin në një aksident apo tragjedi, dhe nuk dihet për ta se a kanë vdekur në të njëjtën kohë apo ndonjëri prej tyre ka vdekur para tjerëve; ose dihet që ndonjëri ka vdekur para të tjerëve, por nuk dihet se cili ka vdekur i pari; Në këtë rast:

- Nëse dihet saktësisht se kanë vdekur të gjithë trashëgimtarët së bashku, atëherë nuk bëhet trashëgimia në mes tyre, dhe për këtë janë pajtuar dijetarët (ixhmai).
- Nëse dihet saktësisht se ndonjëri ka vdekur më vonë, ai trashëgon të vdekurin e mëhershëm, dhe për këtë janë pajtuar dijetarët (Ixhmai).

BUXHETI I SHTETIT SI TRASHËGIMTARË

Kur një njeri vdes e nuk ka lënë trashëgimtarë, pohues të prejardhjes së tij apo testamentmarrës të cilit i ka lënë tërë pasurinë e tij, pasuria e tij i jepet buxhetit të shtetit që të shfrytëzohet në dobi të tërëve.

Arka qëndrore e muslimanëve (Bejtul – mal)

Janë pajtuar që të katër drejtimit (medh'hebet) në atë se: nëse i vdekuri lë pasuri dhe nuk ka kush ta trashëgojë, dhe as nuk ka lënë testament, atëherë ajo pasuri bartet në arkën qendrore (buxhetin) të muslimanëve (bejtul-mal). Vetëm se kjo mënyrë e bartjes së pasurisë, sipas drejtimit hanefijë dhe hanbelijë, nuk bëhet në bazë të së drejtës së trashëgimisë, por si e drejtë e përgjithshme dhe shpërndalet (investohet) për interesin e përgjithshëm të muslimanëve.

	Muhamedi a.s ka porositur: “Mësojeni shkencën e trashëgimisë (feraidit), dhe mësojani të tjerëve, sepse vërtetë ajo është gjysma e diturisë dhe (është dituria) që më së shumti harrohet, ajo është dituria e parë e cila do të ngrihet nga njerëzit.” (Transmeton Ibn Maxhe)	
--	--	--

Librat autoriale dhe të përkthyer (nga autori)

- |1. Besimi në Zotin|
- |2. Melaqet e Zotit|
- |3. Besimi në Librat e Zotit|
- |4. Pejgamberët e Zotit|
- |5. Besimi në Ditën e Kijametit|
- |6. Besimi në Kaderin e Zotit|
- |7. Tregime nga jeta e Muhamedit a.s|
- |8. Fikhu i Namazit|
- |9. Fikhu i Zekatit|
- |10. Fikhu i Agjërimit|
- |11. Fikhu i Haxhit|
- |12. Dashuria|
- |13. Sinqeriteti|
- |14. Drejtësia|
- |15. Amaneti|
- |16. Turpi|
- |17. Durimi|
- |18. Morali|
- |19. Falënderimi|
- |20. Bamirësia|
- |21. Mëshira|
- |22. Bujaria|
- |23. Vërtetësia|

- |24. Emërtoni fëmijët tuaj me emra të bukur|
|25. Nata e dhëndërisë|
|26. Dita e vdekjes dhe e varrimit|

|27. Texhvidi i muslimanit të vogël|
|28. Shkruaj lexo dhe mëso shkronjat e Kur'anit|
|29. Planprogrami i muslimanit të vogël|
|30. Drita e jetës|
|31. Lutjet e jetës nga Kur'ani fisnik|
|32. Këshilltari fisnik për djem dhe vajza (nga autori Muhamed Sajim)|

|33. Trashëgimia|

|34. Vasijeti|

|35. Vakëfi|

|36. Ixhtihadi|

|37. Usuli fikhu për fillestarë|

|38. Kurbani|

|39. Statuti i familjes|

|40. Dëshiroj të jem ai që nuk duhet të jem|

|41. Dëshmorët e Prillit në Rakoc dhe Lagje të Re|

|42. Fadil Çaka – Komandant Sharri||

|43. Texhvidi – Shkenca e të lexuarit (kënduarit) të përpiktë të Kur'anit|

|44. Mrekullitë numerike në Kur'anin Fisnik (nga autori Abdurrezak Nufel)|

|45. (Pa)Mundësia e përkthimit të Kur'anit|

- |46. Tema të zgjedhura dhe të nevojshme|
- |47. Kryesore në terminologjinë e Hadithit (Abduhu Abas El-Velidi)|
- |48. Fjalë të arta të më të mirit të njerëzimit Muhamedit s.a.v.s. (Abdul Fetah Xhemilë Berri)|
- |49. Tregime për ta arritur kulminacionin e mirësisë dhe përsosmërinë e devotshmërisë (nga autori Muhamed Eminë Xhundi)|
- |50. Usuli fikhu islam - I - Ligjet e sheriatit - (Vehbetu Zuhejli)|
- |51. Usuli fikhu islam - II - Përpilimi i ligjeve prej teksteve të sheriatit - (Vehbetu Zuhejli)|
- |52. Usuli fikhu islam - III - Kur'ani dhe Suneti – (Vehbetu Zuhejli)|
- |53. Usuli fikhu islam - IV - Ixhmai - (Vehbetu Zuhejli)|
- |54. Usuli fikhu islam - V - Kijasi - (Vehbetu Zuhejli)|
- |55. Istihسانی (Vehbetu Zuhejli)|
- |56. Parimi i interesit (Vehbetu Zuhejli)|
- |57. Fetavatë (Muhammed Muteveli Esh-Shaëravi)|
- |58. Fundi i botës (Muhammed Muteveli Esh-Shaëravi)|
- |59. Madhështia e islamit (Muhammed Muteveli Esh-Shaëravi)|
- |60. Këto llogariten furnizime (Muhammed Muteveli Esh-Shaëravi)|
- |61. Për Kushtetutën Islame (Dr. Muhammed Sejid Ahmed El- Musejer)|
- |62. Shkurtimi i thonjve në dritën e sunetit dhe mjekësisë (Ebul Vefa Abdul Ahar dhe Jahja Nasir)|
- |63. Islami dhe Politika (Dr. Jusuf Kardavi)|
- |64. Toka e Israsë (Pikat kritike palestinezo-izraelite)|
- |65. Për hulumtuesit e fesë së vërtetë (Muhammed Hisham Tilbete)|

- |66. Vëllazëria në islam dhe zemra e shëndoshë (Amër Halid)|
- |67. Superfuqia në Allahun (Amër Halid)|
- |68. Shpresa duhet të jetë besim dhe veprim (Amër Halid)|
- |69. Bindja e thellë në Allahun (Amër Halid)|
- |70. Shpresa në Allahun (Amër Halid)|
- |71. Shpresa në Allahun duhet të jetë besim dhe veprim (Amër Halid)|
- |72. Vendosmëria në fenë e Allahut (Amër Halid)|
- |73. Pasojat e mëkateve (Amër Halid)|
- |74. Vëllazëria muslimane (Amër Halid)|
- |75. Mjetet e vendosmërisë në fenë e Allahut (Amër Halid)|
- |76. Vlera e kohës (Amër Halid)|
- |77. Serioziteti (Amër Halid)|
- |78. Pozitiviteti (Amër Halid)|
- |79. Pendimi (Amër Halid)|
-
- |80. Trashëgimia në islam (për fillestarë)|

Përmbajtja:

Definicioni i trashëgimisë	2
Ruknet e trashëgimisë	2
Sharti i trashëgimisë	3
Shkaqet e trashëgimisë	3
Pengesat e trashëgimisë	4
Si duhet vepruar me pasurinë e të vdekurit?	5
Llojet e trashëgimtarëve	5
Trashëgimtarët për nga gjinia	6
As'habul furud – personat e nominuar për të marrë pjesë të përcaktuara (farz)	7
Parimi i mbulimit trashëgimor në trashëgiminë islame	10
Mbulim i tërësishëm	10
Mbulimi i pjesshëm	11
Privimi nga trashëgimia	14
Trashëgimia e babës	15
Trashëgimia e nënës	18
Trashëgimia e burrit	22
Gjysma burrit dhe gjysma babait	Error! Bookmark not defined.
Trashëgimia e gruas	24
Trashëgimia e vajzës	26
Trashëgimia e vëllait dhe motrës prej nëne sipas së drejtës islame	29
Trashëgimia e motrës së vërtetë	31
Trashëgimia e motrës nga babai sipas së drejtës trashëgimore islame ..	35
Trashëgimia e vajzës së djalit	41
Trashëgimia e gjyshit nga babai	44
Trashëgimia e gjysheve	47
Trashëgimtarët “Asaba”	50
Kandidatët e nominuar për trashëgimi të papërcaktuar	55

Shtimi apo pakësimi i pjesës trashëgimore (el-Auli)	56
Rastet kur nuk ka nevojë për Aulin dhe kur ka nevojë për Aulin	57
Trashëgimia e farefisit	59
Trashëgimia e fëmijës në barkun e nënës	64
Trashëgimia e personave të pagjetur (humbur).....	68
Paraqitja e të humburit (pagjeturit) pasi që është vendosur se ai është i vdekur.....	69
Marrëveshjet me kompromise (Et Teharuxh)	70
Dispozita e marrëveshjes me kompromis	70
Testamenti me më shumë se një e treta.....	70
Trashëgimia e personave të cilët vdesin së bashku në aksident.....	71
Buxheti i shtetit si trashëgimtarë.....	72
Librat autoriale dhe të përkthyer (nga autori)	73